

VENDIM
Nr. 178, datë 18.5.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s 40, DATË 10.3.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘LAJTHIZA INVEST’ SHA, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘QAMI 1’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 mw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 70/7 prot., datë 17.5.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’ me kapacitet të instaluar 1.730 mw, i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 197, 3.8.2022””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 40, datë 10.3.2022, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 197, datë 3.8.2022, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë me Bashkinë Kukës ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te kjo bashki, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune, duke filluar ky afat nga data 7.7.2022.

3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor të rinovuar jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së saj, brenda datës 4.9.2022.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2 pas korrespondencës së gjatë dhe mbajtjes së një seance dëgjimore më datë 18.1.2023, me përfaqësues të shoqërisë, Bashkisë Kukës dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zyrës Vendore (ASHKZV) Kukës, rezulton se shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin përkatës pronësor që i jep të drejtën për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet në Bashkinë Kukës, duke plotësuar kështu dhe kushtin e kësaj pike, i cili vlerësohet të shfuqizohet.

- Në lidhje me kushtin e pikës 3 të vendimit të Bordit nr. 40/2022, të ndryshuar, që ka të bëjë me depozitim të lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujqor, shoqëria ka bërë me dije se ka aplikuar në datë 18.11.2022, aplikim i cili është konfirmuar edhe nga AMBU në shkresën me nr. 125/1 prot., datë 23.1.2023. ERE ka zhvilluar një korrespondencë të gjatë me AMBU-në dhe së fundi i është drejtuar dhe me shkresën nr. 1397 prot., datë 11.5.2023, në të cilën kërkon orientimin shterues nga ana e saj për mënyrën se si do t’i konsiderojë ERE këto subjekte. Në këto rrethana, vlerësojmë se ERE duhet të shprehet mbi këtë kusht, pasi organi përgjegjës i menaxhimit të burimeve ujqore të përcaktojë në mënyrë shteruese orientimin e tij, për këtë arsye vlerësojmë t’i lejmë shoqërisë një afat 3-mujor për depozitim në ERE të lejes së përdorimit të burimit ujqor të rinovuar.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi